



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIK OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit, 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon:

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika, nenit 16, 17 c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligji nr. 07/l-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/l-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 20 paragrafi.1 i Statutit të Komunës së Lipjanit, 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____2022 të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM PËR LIRIMIN NGA PAGESA E BORXHEVE TË QIRASË JOPROFITABILE TË PËRFITUESVE TË BANIMIT SOCIAL

Neni 1

LIROHEN, nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile të gjithë përfituesit e banimit social që janë të vendosur në 21 banesat e ndara nga komuna, sipas Konkursit publik 1Nr.360-41414 të datës 06.07.2018 që nga dita e shpalljes si familje përfituese, konform Vendimit përfundimtar për shpalljen e familjeve përfituese të banesave komunale sipas programit të banimit 1-360-46751 të datës 24.12.2018 e deri me datën 31.12.2022.

Neni 2

Lirimi nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile për kategoritë e lartëcekura bëhet me qëllim të krijimit të lehtësirave financiare për këto familje me gjendje të rëndë ekonomike edhe në këtë vit të vazhdimit të përballjes me pandeminë COVID -19 si dhe situatës së rënduar në ekonominë e vendit si pasojë e rritjes së çmimeve të të gjithë artikujve elementar jetësor.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Zyra e Kryetarit të Komunës – Sektori pronësor juridik.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim-Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 paragrafi 12.2 pika, nenit 16, 17 c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit nr. 07/l-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/l-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 20 paragrafi.1 i Statutit të Komunës së Lipjanit, 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Komuna e Lipjanit e konsideron të domosdoshme krijimin e disa lehtësirave financiare për këto familje me gjendje të rëndë ekonomike edhe në këtë vit të vazhdimin të përballjes me pandeminë COVID -19 si dhe situatës së rënduar në ekonominë e vendit si pasojë e rritjes së çmimeve të të gjithë artikujve elementar jetësor pasi këto familje me gjendje të rëndë sociale e kanë të vështirë në këtë situatë ti kryejnë me rregull pagesat e qirasë joprofitabile.

Komuna e Lipjanit me këtë propozim –vendim kërkon nga Kuvendi i Komunës që përfituesit e banimit social të lirohen nga pagesa borxheve të qirasë për obligimet e mbetura nga dita e shpalljes si përfitues e deri me datën 31.12.2022.

Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 1-011/01-13839

Lipjan, më 14.03.2022

KRYETARI KOMUNES

Imri Ahmeti

